



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM
Nr. 10, datë 10.02.2016

MBI TARIFAT E UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHOQËRINË
UK DURRËS SHA

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar dhe Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave" Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë UK Durrës Sha:

a. Tarifë volumetrike për shërbimet:

	Furnizim me ujë	Largim e përpunim i ujërave të ndotura
Konsumator familjar	61 lekë/m ³	37 lekë/m ³
Konsumator publik	115 lekë/m ³	54 lekë/m ³
Ente private	125 lekë/m ³	56 lekë/m ³

b. Tarifë fikse

Konsumator familjar	100 lek/muaj/klient
Konsumator publik	100 lek/muaj/klient
Ente private	100 lek/muaj/klient

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2016:

- uji pa të ardhura (humbjet) 60 %
- niveli i matjes 89,2 %
- kohëzgjatja e furnizimi 8 orë/ditë
- efiçenca e energjisë
 - uji i pijshëm 1.3 kwh/m³
 - kanalizime 0.8 kwh/m³
 - ITUN 1.1 kwh/m³
- efiçenca e stafit 4.5 p/000/lidhje
- mbulimi me ujë 85 %
- mbulimi me kanalizime 46 %
- norma e arkëtimit 90 %
- cilësia e ujit (klor+koliform) sipas standarteve

3. Pagesa rregullatore vjetore për UK Durres Sha do të jetë 0.8% e të ardhurave të llogaritura.

4. Vendimi KKRR nr.36 datë 19.12.2011 "Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Sha UK Durres" si dhe vendimi i KKRR nr 24 datë 03.06.2013 "Për disa ndryshime në vendimin e KKRR nr 36 datë 19.12.2011 "Për miratimin e tarifave për konsum publik për Sha UK Durres dhe për shfuqizimin e vendimit të KKRR nr.24 datë 01.10.2012 "Për miratimin e tarifës së shërbimit për largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura për Sha UK Durrës" shfuqizohen.

5. Ky vendim hyn në fuqi më 01.03.2016 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi